

# STATUTI I SHOQERISE Me PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## "R-META" SHPK

### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

#### EMËRTIMI

Sot me date 24/05/2023, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

**Z. REBIUL ISUF META**, shtetas Shqiptar, i lindur me 09.08.1996 ne Shkodër dhe

banues ne Shkodër, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, themelon ne cilesine e Ortakut te Vetem, Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **"R-META" SHPK** .

Shoqëria e ka selinë në Bërdicë e Sipërme, Rruga Nationale Shkodër-Lezhë, km6, numri i pasurisë 90/28, zona kadastrale 1159, Shkodër. Shoqëria ka të drejtë të celë filial, degë e përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë e jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar e ato të vendeve të tjera ku ato do të hapen.

**Z. REBIUL ISUF META** është administrator I shoqërisë për afat 5 vjecar.

Neni 2

Shoqëria **"R-META" sh.p.k.** e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj (statute). Shoqëria **"R-META"** është person juridik.

Neni 3

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria krijohet për të kryer veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje mbi 10 (dhjetë) vjet. Shoqëria mund të zgjasë afatin e veprimtarisë së saj ose mind ta mbyllë aktivitetin e saj para këtij afatit, sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut dhe sipas kriterëve që përcaktohen nga lejislacioni në fuqi.

Neni 4

Shoqëria për detyrimet qe do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e shoqërisë.

Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

Neni 5

Objektivi I veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria do të ketë si objektiv dy pika:

Veprimtari në fushën e tregtimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, dhe vajra lubrifikante.

## KREU II MARRËDHËNIET EKONOMIKE-FINANCIARE

### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar I shoqërisë është 100,000 lekë.

I ndarë ky capital në 1 pjesë, vlera nominale e së cilës është 100,000 lekë.

Ky kapital themelor zotërohet nga ortaku I vetëm I shoqërisë I ndarë në masën 100 % (njëqind përqind).

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve ashtu edhe kundrejt personave të tretë. Transferimi I kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakëve dhe me akt notarial.

Në qoftesë njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortakët e e tjerë, se aprovimin e tyre unanimit për shitjen e pjesës së tij një subjekti tjetër.

Vlerësimi I kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të vecantë ose nga një ekspert kompetent I caktuar nga ortakët.

### Neni 7

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit themeltar bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të vecantë.

### Neni 8

Fitimet neto të realizuara nga aktiviteti I shoqërisë do të ndahen ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre pjesmarrëse në kapitalin themeltar.

### Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdive ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet brenda muajit mars të vitit që vijon.

Bilanci i aktivitetit financiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertët e tyre. Por në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit financiar duhet të aprovohen nga Asambleja e Ortakëve brenda muajve të mbylljes së vitit financiar.

### Neni 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zgjerimin e aktivitetit. Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre caktohen nga Asambleja e Ortakëve.

### Neni 11

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

### KREU III

#### Neni 12

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve -Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë,në përputhje me kontratën dhe statutin. -Të kërkojnë dhe tu japin të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci,libra llogarie). - Të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë. -Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

#### Neni 13

Ortakët kanë këto detyra kryesore: -Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe vendimet e Asamblesë (për fondin rezervë). -Të marrin pjesë në administrimin nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë. -Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.

### KREU IV

#### ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

#### Neni 14

Organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Në Asamble marrin pjesë të gjithë Ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vendosura në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e ortakëve kryen keto funksione:

- Miraton bilancin vjetor të shoqërisë
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themeltar.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë
- Emeron dhe revokon ekspertin kontabël të shoqërisë.
- Kryen modifikime në statut sipas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj në një tip tjetër shoqërie.

#### Neni 15

Administratori i shoqërisë është **REBIUL ISUF META**, është Ortak i vetëm dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në, me, dhe për llogari të shoqërisë. Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijnë nga veprimet e kryera nga administratori. Administratori ka afat maksimal 5(pesë)vjet dhe afati është i detyrueshëm të parashikohet në aktet e shoqërisë.

Neni 16

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, si dhe shkelje të kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 17

Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë rregullohen me kontrata individuale që do të lidhen me secilin prej tyre.

**KREU V**  
**MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË**

Neni 18

Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratë nëqoftëse Ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk zgjatin këtë afat. Shoqëria mund t'i japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 19

Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit. Pasuria e shoqërisë, pasi shlyen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes Ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar. Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarëve të saj.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**  
**REBIUL ISUF META**

